



Prishtinë, 04 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1417_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,
bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 39 dhe 40/2 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;

në seancën e mbajtur më 04 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

PËR HAPJEN E PROCEDURES SË TENDERIMIT PËR ZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

- I. **SHPALLET** Tenderi për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF).
- II. Furnizuesit që aplikojnë për të ofertuar në procedurën e tenderimit duhet të demonstrojnë se përmbushin kriteret e dhëna në nenin 4 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- III. Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të jetë i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit ashtu si janë përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullin për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me energji elektrike dhe Licencën përkatëse të lëshuar nga Rregullatori.
- IV. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të caktohet për një periudhë tre (3) vjeçare.
- V. Si Furnizues i Mundësisë së Fundit do të zgjidhet furnizuesi i cili ofron koston më të ulët të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike, siç është definuar në Rregullën për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit;
- VI. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
 - furnizuesit e tyre kanë bankrotuar apo është në procedurë likuidim;
 - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar; dhe

- konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.
- VII. Konsumatorët e referuar në pikën VI të dispozitivit të këtij Vendimi kanë të drejtë të shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për një periudh jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- VIII. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të filloj furnizimin me energji elektrike me ndërprerjen e kontratës së konsumatorit me furnizuesin e mëparshëm ose kur furnizimi fillon për konsumatorin e ri, por që kontrata nuk është nënshkruar me një furnizues tjetër.
- IX. Procedura e Tenderimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të udhëhiqet nga Rregullatori.
- X. Njoftimi për dorëzimin e ofertave nuk do të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit të njoftimit.
- XI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- XII. Vendimi hyn në fuqi me datën e aprovimit nga Bordi, dhe do publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar